



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. **104** prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 12 / 08 / 2025

VENDIM

Nr. 25 datë 12 / 08 / 2025

PËR

PROJEKT ZBATIMIN E RISHIKUAR TË OBJEKTIT

“Rehabilitim i digës së Pepel 1, Bashkia Dropull”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 12.08.2025 mori në shqyrtim Projekt zbatimin e rishikuar të paraqitur nga Bashkia Dropull për Rehabilitimin e digës së Pepel 1.

Ky projekt është përgatitur nga firma konsulente “SIRE-ALB” dhe e dorëzuar në SKDM nga bashkia Dropull. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se projekti është i plotësuar me studimin dhe raportin gjeologjik, llogaritjet e qëndrueshmërisë së digës dhe raporti për instrumentat e monitorimit të digës. Gjithashtu, projekti është i shoqëruar me Oponencën e kryer nga Instituti i Ndërtimit (IN) në të cilën janë lënë disa detyra që nuk janë plotësuar nga firma projektuese.

Gjatë shqyrtimit të projektit nga ekspertet e KKDM, rezulton se vendosja e një shtresë betonarme në anën e sipërme të digës nuk është i argumentuar dhe nuk është i nevojshëm për tu vëndosur. Kjo shtresë jo vetëm që ndryshon kushtet e punës të digës së ndërtuar me material argjile por nuk luan asnjë rol përmirësues në funksionimin e saj. Gjithashtu, në vizatimet e projektit mungojnë shumë detaje teknike të kësaj shtrese betonasi dhe detaje të tjera teknike për veprën e marrjes së digës dhe për sistemin e shkarkimit të saj. Sistemi i monitorimit të digës I parashikuar në projekt nuk është korrekt dhe nuk kryen funksionin për të cilin është parashikuar. Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM:

VENDOSI:

- 1- Të mos miratoj propozimin e firmës projektuese për shtresën betonarme në anën e sipërme të digës si dhe skemën e sistemit të monitorimit të digës. Projekti duhet të plotësojë kërkesat e Oponencës teknike të IN dhe të japë detajet teknike të nevojshme për riparimin e veprës së marrjes dhe sistemit të shkarkimit të digës.
- 2- Ti kërkoj Bashkisë Dropull si shfrytëzuese e digës së Pepel 1
 - Të plotësojë detajet e projektit të kërkuar më sipër dhe kërkesat e oponencës së IN.
 - Të kryejë riparimet e duhura të shtresës ekzistuese me gurë dhe të plotësojë këtë shtresë në pjesën e sipërme të anës së sipërme të digës me gurë sipas kërkesave teknike të këtyre shtresave me një gjërësi jo më shumë se 5 m për zvogëlimin e efektit të dallgëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

- Të rishikoj vendndodhjen dhe skemën e vendosjes së instrumentave të monitorimit të digës sipas kërkesave të KKDM dhe standarteve teknike.
- Të kryejë vetëm punimet që kanë lidhje me riparimin e digës dhe të kurorës së saj që nuk sjellin ndryshime të parametrave të objektit dhe nënobjekteve nga c'ka është projektuar në projektin origjinal sipas kërkesave të nenit 27 të VKM Nr. 147 të mësipërme.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM dhe ITD për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI